



Pasqyrë e Mundësisë të Krediteve në Taksa të Programit të Bursave të Studimit

Lënda: Mundësia e Krediteve në Taksa e Programit të Bursave të Studimit, ofron mundësi për nxënësit që të marrin bursa, nëse dëshirojnë të ndjekin shkollat publike ose private, sipas zgjedhjes së tyre.

Vlefshmëria: Mundësia e Krediteve në Taksa e Programit të Bursave të Studimit, lejon që bizneset e ndryshme të kontribuojnë në organizata që japin bursa për nxënësit, që ndjekin shkollat e lagjes të cilat kanë rezultate të ulta. Shkolla me “rezultate të ulta”, përcaktohet si shkollë publike fillore ose tetëvjeçare në Pensilvani, e cila rreshtohet në fund të 15 përqindshit, sipas përkatësisë së saj si shkollë fillore ose tetëvjeçare, bazuar në rezultatet e kombinuara në matematikë dhe lexim, në testin më të fundit të PSSA. Ky term nuk përfshin shkollën charter, atë “cyber charter”, ose shkollën tekniko profesionale. Nxënësit (përfshirë ata që hyjnë në klasat e kopshtit) që jetojnë në kufijtë e shkollës së lagjes me rezultate të ulta, që nga dita e parë e shkollës, janë të vlefshëm që të aplikojnë për mundësi të marrjes së bursave. Nxënësit që janë të vlefshëm për këtë program, përfshijnë fëmijët që jetojnë në zonën e lagjes të një shkolle me rezultate të ulta, të cilët:

- Aktualisht ndjekin shkollën me rezultate të ulta;
- Aktualisht ndjekin një shkollë jo publike;
- Më përpara kanë marrë mësim në shtëpi; ose
- Më përpara kanë ndjekur një shkollë “charter ose cyber charter”.

Nxënësit që mund të përfitojnë përcaktohen si ata fëmijë që janë në moshën e shkollës, që jetojnë në zonën e një shkolle me rezultate të ulta, që nga dita e parë e shkollës dhe që të ardhurat e familjes plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Deri më 30 Qershor 2013: \$60,000 plus \$12,000 për çdo pjestar në vartësi të familjes;
- 1 Korrik 2013 deri 30 QESHOR 2014: \$75,000 plus \$15,000 për çdo pjestar në vartësi të familjes;
- Për nxënësit me paaftësi, do të bëhen korigjime të tjera shtesë, në përputhje me ligjin.

Departamenti i Edukimit i Pensilvanisë do të publikojë çdo vit listën e 15 përqindshit të fundit të shkollave fillore dhe tetëvjeçare, bazuar në rezultatet e kombinuara të Matematikës dhe Leximit të testit PSSA dhe identifikimin e tyre si shkolla me rezultate të ulta.

Vlera e Bursave të Studimit, që mund të përfitohet: Maksimum i vlerës për një bursë studimi, që mund t’i jepet një nxënësi është si më poshtë:

- \$8,500 për nxënësit të shëndetshëm
- \$15,000 për një nxënësit me paaftësi

Fondet: Mundësitë për bursa studimi krijohen nga biznese që japin kontribute në organizatat e dhënies së bursave të studimi, në këmbim të krediteve në taksa. Vlera e bursës së studimit nuk mund të kalojë vlerën e kontributit të biznesit në organizatën që trajton këto bursa studimi. Edhe nëse një nxënës është i vlefshëm për bursë studimi, kjo bursë do të akordohet nëse ka fonde në gjendje.

Kërkesat: Bursa e studimit mund të përdoret për koston e shkollimit dhe pagesa që lidhen me pjesëmarrjen në shkollën jo publike, ose në shkollën publike të Drejtorisë Arsimore, që nuk ndodhet në lagje. Një bursë studimi nuk mund të akordohet për program mësimor që zhvillohet në shtëpi. Vlera e kombinuar e bursës së studimit, nuk mund të kalojë vlerën e kërkuar për shkollimin dhe pagesat që lidhen me pjesëmarrjen në shkollë. Fondet e bursës së studimit të marra nga prindërit, nuk konsiderohen si të ardhura për efekt të taksimit. Një shkollë publike, ose private nuk mund të aplikojë pagesa më të mëdha për nxënësit që përfitojnë bursa studimi, se ato që janë normale për nxënësit pa bursa studimi.

Transporti: Një shkollë që ofron transport për nxënësit e saj, duhet të ofrojë transport për një nxënës që vazhdon një shkollë jo publike me bursë, në një distancë deri 10 milje të kufijve të zonës së shkollës publike. Një shkollë që ofron transport për nxënësit e saj, duhet të ofrojë transport për një nxënës që vazhdon një shkollë publike, në një distancë deri 10 milje të kufijve të zonës së shkollës publike

Si të Aplikoni për Marrjen e Bursës së Studimit: Bursa e studimit mund të akordohet nga organizat e miratuara për këtë qëllim, dhe jo nga Departamenti i Komuniteti dhe i Zhvillimit Ekonomik(DCED) apo Departamenti i Edukimit. Lista e organizatave të bursave të studimit është në uebsajtin e DCED, www.newpa.com/ostc. Ky link ofron instruksione specifike se si të kontaktoni organizatat e miratura për bursat e studimit. Organizatat e miratura për bursat e studimit ofrojnë detaje në lidhje me procesin e aplikimit. Prindërit duhet të punojnë me organizatat e miratuara dhe jo me DCED, për të përfituar nga ky program.

Dhënja e Bursave të Studimit: Në dhënjen e bursës së studimit, një organizatë e dhënjes së bursave do t'i japë më tepër përparësi aplikantëve të cilët:

- Kanë marrë një bursë studimi një vit më parë;
- Ata të cilët plotësojnë disa limite të të ardhurave; ose
- Ata të cilët plotësojnë disa limite të të ardhurave dhe banojnë në një drejtori arsimore të nivelit të parë, një drejtori me një numër ditor antarësh më tepër se 7,500, që ka marrë ndihmë paraprake për edukimin bazë të tij, ose një drejtori që ka marrë ndihmë paraprake për edukimin bazë të tij dhe është subjekt i një stresi financiar të deklaruar, sipas seksionit 691 të kodit të shkollës publike, ose është përfshirë në çeshtje gjyqësore kundër shtetit, ndaj të cilit drejtorja arsimore kërkon asistencë financiare për vazhdimin e punës së përditëshme të drejtorisë arsimore.

Përgjegjësitë Prindërore: Sipas programit, prindërit janë përgjegjës për kontaktimin dhe përfshirjen e nxënësve të tyre për bursa studimi në shkollat publike dhe private.

Për informacione dhe dokumenta të tjerë të përkthyer në Gjuhën Shqipe, ju lutemi vizitoni uebsajtin:

www.philasd.org/language/albanian